



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C – IV. – 15 – 0706

Paditësi :

I C, nga Prishtina, përfaqësuar nga K B nga Hajvali

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lagjja, ”Lakrishtë” Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me dt..08.2023, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, I C nga Prishtina, dhe **VËRTETOHET**, Vendimi PRN126 – 0076 dt.31.03.2015 i Autoritetit të Likuidimit pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), **si e drejtë dhe i bazuar në ligj**.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Paditësi përmes postës, me dt.29.04.2015, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), ka parashtruar padi kundër Vendimit PRN126 – 0076 dt.31.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH) “Auto - Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) e me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij në emër të kompensimit e pagave të paguara në shumën prej 11,440.00 € për periudhën prej dt.30.09.2003 deri në qershor 2014 NSH “Auto - Prishtina” me seli në Prishtinë (në likuidim) e me të cilën ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të aprovohet padia dhe kërkesa e paditësit si e bazuar, të detyrohet, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit që paditësit, t’ia paguaj borxhin kryesor për pagat e pa paguara për periudhën e lartë cekur kohore, si dhe t’ia paguaj kamatën ligjore vjetore, prej 3.5 % për çdo vit.

Paditësi në këtë padi/kërkesë, ka theksuar NSH është regjistruar pranë UNMIK si SH.A “Auto Prishtina” dt. 24.05.2000, të cilët ishin punësuar 38 punonjës që kishin qenë të punësuar në këtë NSH para marsit 1999. I punësuarit në NSH së bashku me të punësuarit nëpërmjet menaxhmentit dhe kryesisë së sindikatës kishte depozituar një Regjistër me nr.4 dt.12.06.2014,

i cili përmbante emrin e të punësuarit, pagën mujore, periudhën kohore tetor 2003 - qershor 2014 gjegjësisht 130 muaj, për të cilën nuk ishin paguara pagat e të punësuarve në tërësi për 38 të punësuar siç janë cituar në regjistër dt. 12.06.2014 i cili u pranua nga e paditura AKP dt.12.09.2014. Më tej citon se paditësi nuk ka pushuar së kërkuari pagesën e pagave mujore sipas kontratës deri në njoftimin se për NSH ka filluar procedura e likuidimit, për të cilën ka marrë veprime të ndryshme ligjore për realizimin e të drejtës në pagesën e pagave dhe kontributeve pensionale.

Paditësi kësaj ankese ia ka bashkangjitur provat kopje: libreza e punës, certifikatën për regjistrimin e biznesit dt.24.05.2000, konfirmim biznesi dt.17.04.2000, njoftimin adresuar AKP dt.23.04.2015, shkresën e AKM dt.18.11.2004, shkresën e AKM dt. 19.08.2004, lista e punëtorëve dt.12.06.2014, lëshuar nga Auto Prishtina, kontratë pune nr. 232, të NSH “Auto Prishtina dhe deklarata e paditësit

Me dt.02.02.2023, e paditura ka paraqitur mbrojtjen e saj në padinë e paditësit e në të cilën, ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit, ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL, se kërkesa e parashtruesit është parashkruar bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.03/L 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit lidhur me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar që sanksionon parashkrimin brenda tre vjetësh, e duke i propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa si e pa pranueshme dhe e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimin i Autoritetit të Likuidimit në bazë të nenit 74.4 të Ligjit, Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme. Mbrojtjes ia ka bashkangjitur kopje: Vendimin PRN126-0076 dt.31.03.2015 të AL-së.

Me Urdhrin dt.24.04.2023, gjykata ia ka adresuar paditësit, mbrojtjen e të paditurës për mundësinë që brenda afatit 7 ditëve për të paraqitur përgjigje në këtë mbrojtje dhe të cilën paditësi me dt.02.05.2023, ka paraqitur përgjigje ndaj mbrojtjes së të paditurës së bërë në padinë e paditëses dhe me precizim të kërkesëpadisë lidhur me kamatën ligjore në 10 % sipas konform nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP, e në të cilën në mes tjerash ka kundërshtuar në tërësi mbrojtjen e të paditurës duke e konsideruar si tendencë për të futur në lajthim gjykatën duke iu referuar në mënyrë selektive disa aktgjykimeve të cilat janë marrë në shkallë të parë, ndërsa në pretendimet tjera paditësi i referohet përsëritjes së kërkesës me rastin e paraqitjes në këtë gjykatë.

Me urdhrin dt.04.05.2023, gjykata ia ka adresuar të paditurit përgjigjen e paditësit, për të cilën e paditura me shkresën kundërpërgjigje dt.15.05.2023, ku i referohet përkufizimeve që janë dhënë në mbrojtje duke cituar se parashtruesi ka detyrimin dhe barrën e provës (nga neni 7 i LPK dhe neni 31 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme)

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Ligji i Dhomës së Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata marr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit, duhet të refuzohet si e pabazuar:

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.

Në nenin 36 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) që flet për pranueshmërinë e një kërkesë/ankese, aty thuhet se : ” ... Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; paditësi ka të drejtë të nisë procedurat në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; kërkesa/ankesa paraqitet kundër një pale që mund të jetë palë kundërshtare në procedurat para Dhomës së Posaçme, në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; kërkesa/ankesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi kur janë të aplikueshme; kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji. është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa”.

Në nenin 74 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) që flet për shqyrtimin e vendimeve të Autoritetit për likuidim aty thuhet se : ”Procedura para Dhomës së Posaçme për kundërshtimin e vendimit të një Autoriteti të Likuidimit që është duke kryer likuidimin e një ndërmarrje ose aseti sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të rregullohet në bazë të këtij neni. Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e kështu duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2 të nenit 35 të këtij ligji dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi”.

Në nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, parashihet se : ”Kreditori i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kerkimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit”.

Gjykata gjenë se për NSH “Auto Kosova” me seli në Prishtinë (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit dt. 21.07.2014 dhe se ankuesi me dt.11.09.2014, ka parashtruar kërkesën për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën shtator 2003- qershor 2014 në shumë prej 11.400.00 euro.

Gjykata, vlerëson se padia/ankesa e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë në kuptimin procedural nga dispozitat e lartë cekura ligjore por edhe se e njëjta padi/kërkesë për ri shikim, pranë e DHPGJSK-së, është bërë brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditë/ së pranimit të Vendimit të kontestuar të AL-së derisa kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese në mesë të palëve ndërgjyqëse, pra paditësit dhe të paditurës, NSH “Auto Kosova” me seli në Prishtinë (në likuidim), ka ekzistuar raporti juridik i

marrëdhënies së punës, dhe se nuk është kontestuese se paditësi në vetë deklaratimet e tij ka cituar se ka realizuar mjete monetare mujore në formë akontacioni për të njëjtën periudhë të pretenduar kohore, ndërsa tani kërkon që nga NSj-ja, të realizoj diferencën e shumës së pretenduar për pagat e pa paguara për periudhën shtator 2003- qershor 2014 në shumë prej 11.400.00 euro, për të cilën ka paraqitur kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit dt.11.09.2014, pra brenda afatit për paraqitjen e kërkesave tek AL-ja, për të cilën kërkesa e tij është refuzuar si e pa vlefshme dhe atë me Vendimin PRN126 – 0076 dt.31.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit dhe atë për shkak të parashkrimit të kërkesës në kuptim të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L 034 për AKP-në dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Gjykata gjenë se vendimi PRN126 – 0076 dt.31.03.2015, me të cilën është refuzuar kërkesa e palës përmban faktin se AL kishte vlerësuar kërkesën e paditësit e cila kërkesë refuzohet bazuar në arsyet si më poshtë konform nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, e në këtë rast ankuesit nuk i është kontestuar marrëdhënia e punës se i njëjti ka qenë punënonjës në këtë ndërrmarje, por se kontestuese për gjykatën mbetet besueshmëria e kërkesës për periudhën kohore të kërkuar nga periudhën për periudhën shtator 2003- qershor 2014 në shumë prej 11.400.00 euro, për të cilën paditësi nuk i bënë të besueshme pretendimet e paraqitura.

Gjykata ka shqyrtuar listën e punëtorëve të hartuar nga punonjësit e NSH lidhur me periudhën e pretenduar dhe ka gjeturë se AL pjesërisht drejtë ka vendosur me rastin e refuzimit të kërkesës në zbatim të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, për periudhën shtator 2003- qershor 2014, pasi që kërkesa nga muaji shtator 2003 - maj 2011, është parashkruar meqë kërkesat e pretenduara për paga të papaguara janë kërkesa mujore dhe secila kërkesë veq e veq ka fatin e vetë të parashkrimit, ndërsa lidhur me periudhën qershor 2011- qershor 2014, paditësi për periudhën tani të veqar në shumë të papërcaktuar nuk mund të marrë si të besueshme, meqë kjo e llogaritje e pagave duhet të ishte miratuar edhe nga autoriteti kompetent i AKP si borxh eventual, e jo vetmë nga punonjësit e NSH. Baza e kërkesës dhe numri i pagave të kërkuara në këtë procedurë duhet të mbështetet plotësisht me provat përkatëse të besueshme. Pra, në këtë kuptim, ankuesi ka dështuar që të parashtrijë prova në mbështetje të kërkesës së tij. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj gjykata konstaton se kërkesën mbi bazën e fakteve të paraqitura të paditësit para AL dhe tani para gjykatës nuk mund të marrë si të besueshme në aprovimin e kërkesës gjegjësisht ankesës së palës, në shqyrtimin e mëtejshëm të fakteve vendimtare lidhur me provat e prezantuara ka gjetur se me vendimin PRN126 – 0076 dt.31.03.2015, AL drejtë ka vepruar me rastin e refuzimit të kërkesës, pasi që kërkesa e palës duhet të mbështetet në fakte dhe prova që vërtetojnë një pretendim të tillë të parashtruesit dhe se Baza e kërkesës dhe numri i pagave të kërkuara në këtë procedurë duhet të mbështetet plotësisht me provat përkatëse të besueshme. Pra, në këtë kuptim, ankuesi ka dështuar që të parashtrijë prova në mbështetje të kërkesës së saj. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës

Gjykata vlerëson se, qëndrimi i të paditurës se kërkesa e parashtruesit për paga të papaguara që pretendohet të mos jenë paguar sipas nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, lidhur me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), është i drejtë, duke vlerësuar si të pavlefshme të kërkesën, bazohet në obligimet e palëve në procedurë se në rastin kur pala

pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi, dhe Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) dhe se neni 42.3 i Ligjit nr. 06/L – 086, në mënyrë shprehimore citon se “... Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”, për të cilën pala paditëese nuk ka paraqitur para kësaj gjykate vendimmarëse.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

**Gjykatësi
Agron Hoxhaj**